




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Telkos
Enver Berisha
Drejtor
Prishtinë



VENDIM

**Lidhur me Ankesën nr. 2020/99 Telkos (Palë ankuese)
kundër Klan Kosova**

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2020/01, e cila ka hyrë në fuqi më 3 nëntor 2020. Me këtë Rregullore janë përcaktuar rregullat dhe procedurat për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale nga ana e operatorëve, të cilët pavarësisht teknologjisë së përdorur, shpërndajnë përmbajtje audio dhe audiovizuale.
2. KPM, me datën 16 nëntor dhe 10 dhjetor 2020, ka pranuar Ankesa të parashtruar nga Pala ankuese ndaj OSHAM Klan Kosova me pretendimin e shkeljes së nenit 10 të Rregullores KPM-2020/01, për shkak të ndërprerjes së sinjalit nga ana e Klan Kosovës dhe dhënien e të drejtës ekskluzive operatorit Artmotion si dhe diskriminimit që i është bërë Palës ankuese në raport me operatorin Artmotion dhe IPKO.
3. KPM, në lidhje me Ankesën e pranuar me datën 8 dhjetor 2020, i është përgjigj Palës ankuese në lidhje me obligimet që dalin nga Rregullorja e re KPM-2020/01, duke e njoftuar se sipas nenit 10, paragrafi 1, Pala ankuese është e obliguar që fillimisht të sigurojë marrëveshje të transmetimit nga dhënësit e të drejtave, ndërsa në lidhje me obligimet e OSHMA-ve karshi Rregullores se re do të zhvillohet procedurë e veçantë.
4. KPM, në lidhje me Ankesën tjetër të Palës ankuese, atë të datës 10 dhjetor 2020 lidhur me çështjen e diskriminimit, me datën 15 dhjetor 2020, përmes një shkresë ka kërkuar nga Klan Kosova që të na njoftojë lidhur me të drejtat që kjo e fundit i ka dhënë operatorit Artmotion dhe IPKO, për të vlerësuar çështjen e diskriminimit në raport me Palën ankuese.
5. Klan Kosova me datën 28 dhjetor 2020, përmes një Përgjigjeje ka sqaruar se ka arritur marrëveshje me operatorin Artmotion të cilën e ka deponuar në KPM, ndërsa ka sqaruar se me operatorin IPKO kanë marrëveshje valide deri në muajin qershor 2021 dhe se të njëjtën janë të obliguar ta respektojnë.

6. KPM, ka gjetur se OSHMA Klan Kosova (përmes përfaqësuesit të autorizuar Artmotion) me datën 9 nëntor 2020, i ka dërguar ofertë Palës ankuese, e cila ofertë është deponuar në KPM si dëshmi.

Analiza ligjore

7. KPM pretendimet ankimore të Palës ankuese i ka trajtuar në kuptim të nenin 10, paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2020/01.

Neni 10, paragrafi 1, i Rregullores KPM-2020/01, përcakton se:

“OSHMA-të të cilat nuk e gëzojnë statusin e bartjes së obligueshme, mund të barten nga operatorët e shpërndarjes vetëm në bazë të marrëveshjes valide.”

8. KPM, ka njoftuar Palën ankuese se OSHMA-të të cilat nuk e gëzojnë statusin e bartjes së obligueshme (ato të cilat janë jashtë brezit-frekuencor radio-difuziv), mund të barten vetëm mbi bazën e një marrëveshjeje valide të arritur me bartësin e të drejtës. Në bazë të këtij neni mbetet obligim i operatorëve të shpërndarjes që të sigurojnë marrëveshje valide për bartjen e një OSHMA-je e cila transmeton jashtë brezit frekuencor.

Ndërsa neni 10, paragrafi 2, i Rregullores KPM-2020/01, përcakton se:

“OSHMA-të, pavarësisht formës së transmetimit, duhet të ofrojnë sinjalin në baza jo-diskriminuese dhe jo-ekskluzive ndaj të gjithë operatorëve të shpërndarjes, në mënyrë që publiku të mos përjashtohet nga qasja në informim.”

9. Në lidhje me pretendimin ankimor se OSHMA Klan Kosova ka diskriminuar Palën ankuese në raport me operatorin Artmotion dhe IPKO, KPM ka iniciuar procedurë të vlerësimit dhe ka kërkuar sqarim nga OSHMA Klan Kosova. OSHMA Klan Kosova, ka sqaruar se i ka përcjellë ofertë të gjithë operatorëve të shpërndarjes ku me disa prej tyre kanë arritur marrëveshje, duke deponuar edhe marrëveshjen e lidhur me operatorin Artmotion.
10. Në lidhje me operatorin IPKO, Klan Kosova ka sqaruar se kanë marrëveshje valide deri në muajin qershor 2021, e cila i obligon që ta respektojnë, dhe se pas kalimit të afatit të marrëveshjes operatori IPKO do ta këtë ofertën si të gjithë operatorët tjerë. KPM vlerëson se raporti kontraktual në mes të OSHMA Klan Kosova dhe IPKO, në këtë fazë, nuk mund të vlerësohet sipas nenit 10, paragrafi 2 të Rregullores KPM-2020/01, për shkak të efektit ligjor të marrëveshjes e cila tashmë është në fuqi në mes të OSHMA Klan Kosova dhe operatorit IPKO dhe është lidhur para hyrjes në fuqi të Rregullores KPM-2020/01.
11. KPM, vlerëson se procedura lidhur me pretendimin ankimor të Palës ankuese në raport me IPKO-n, duhet të vazhdojë me komunikime shtesë me palët e përfshira në proces, deri në sqarimin përfundimtar të kësaj çështjeje.


12. Në lidhje me pretendimin ankimor për shkelje të paragrafit 2 të nenit 10 (çështja e ekskluzivitetit), në bazë të dëshmive të siguruara nga monitorimi i operatorëve të shpërndarjes (Artmotion dhe IPKO) sqarimeve dhe kontrata tjera të deponuara nga OSHMA Klan Kosova, është gjetur se nuk kemi të bëjmë me ekskluzivitet në kuptimin e transmetimit (për faktin se ekskluziviteti nënkupton që vetëm një operator ta ketë të drejtën e transmetimit, ndërsa në këtë rast të drejtat i kanë më shumë se një operator) mirëpo në kuptimin e përfaqësimit në lidhjen e raporteve kontraktuale.
13. Prandaj, KPM, duke u bazuar në faktet e lartpërmendura, gjen se OSHMA Klan Kosova është në pajtueshmëri me nenin 10, paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores KPM-2020/01.

Vendim

14. Refuzohet si e pabazuar Ankesa e Palës Ankuese, përmes së cilës pretendohet se OSHMA Klan Kosova ka vepruar në kundërshtim me nenin 10, paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores KPM-2020/01.

E drejta për ankesë

15. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
16. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Xhevat LATIFI
Kryetar



28.01.2021
Datë